



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AVOKATI I POPULLIT**



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

**Nr. Prot.**  
**Nr. Dok. 201700495/2**

**Tiranë** \_\_\_/\_\_\_/2017

**Lënda:** *Rekomandojmë marrjen e masave për të garantuar të drejtën e votës për personat me aftësi të kufizuara në territorin e Republikës së Shqipërisë.*

**Drejtuar:** **Z. Denar BIBA**  
**Kryetar i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve**

**TIRANË**

***I nderuar zoti Kryetar,***

Institucioni i Avokatit të Popullit, si një institucion kushtetues, ka në fokusin e tij të punës edhe mbrojtjen e promovimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara.

Bazuar në nenin 16 të ligjit nr. 93/2014 "Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara", Avokati i Popullit është një institucion monitorues për zbatimin e këtij ligji në përputhje me Konventën e OKB-së "Për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara".

Në nenin 29 të Konventës për pjesëmarrjen në jetën politike dhe publike, është përcaktuar se:

" Shtetet Palë duhet tu garantojnë personave me aftësi të kufizuara të drejtat politike dhe mundësinë për t'i gëzuar ato njësoj si pjesa tjetër e popullësisë dhe duhet të marrin përsipër:

(a) Tu garantojnë personave me aftësi të kufizuara pjesëmarrjen e plotë dhe efektive në jetën politike dhe publike njësoj si gjithë të tjerët, drejtpërsëdrejti apo nëpërmjet përfaqësuesve të zgjedhur, duke përfshirë edhe të drejtën dhe mundësinë e personave me aftësitë kufizuara për të votuar dhe për tu zgjedhur, ndër të tjera duke:

(i) Siguruar që procedurat, facilitetet dhe materialet e votimit të jenë të përshtatshme, të aksesueshme dhe të thjeshta për tu kuptuar dhe përdorur;

(ii) Mbrojtur të drejtën e personave me aftësi të kufizuara për të votuar me votë të fshehtë në zgjedhje dhe referendumet publike, pa kërcënim, për të kandiduar në zgjedhje, për të ushtruar funksione publike dhe për të kryer të gjitha funksionet publike në të gjitha nivelet e qeverisë, duke lehtësuar përdorimin e teknologjive asistuese dhe të reja, ne rastet e përshtatshme;

*(iii) Garantuar shprehjen e vullnetit të lirë të personave me aftësi të kufizuar si zgjedhës dhe për këtë qëllim, kur është e nevojshme, me kërkesën e tyre, lejohet asistenca në votim nga një person i zgjedhur prej tyre.”*

E drejta e votës, për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur, si e drejtë kushtetuese parashikohet shprehimisht në Kushtetutën e Shqipërisë, në nenin 45 të saj, ku thuhet se: *“Çdo shtetas që ka mbushur tetëmbëdhjetë vjeç, qoftë edhe ditën e zgjedhjeve, ka të drejtën të zgjedhë dhe të zgjidhet”* ; në ligjin nr. 10019 datë 29.12.2008 “Kodi zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, ku kjo e drejtë kushtetuese rikonfirmohet edhe si parim bazë i këtij kodi si dhe detajohen në mënyrë të qartë mënyrat e ushtrimit të kësaj të drejte. Sipas nenit 3, pika 3: *“...b) Çdo shtetas shqiptar, që ka mbushur moshën 18 vjeç, qoftë edhe ditën e zgjedhjeve, pa dallim race, etnie, gjinie, gjuhe, bindje politike, besimi, aftësie fizike ose gjendjeje ekonomike, ka të drejtë të zgjedhë dhe të zgjidhet, në përputhje me rregullat e parashikuara në këtë Kod”*.

Kodi ynë zgjedhor, në nenin 108 të tij, ka përcaktuar procedurat e votimit për zgjedhësit që nuk mund të votojnë, duke filluar që nga regjistrimi në listat e zgjedhësve të qendrës përkatëse të votimit, infrastrukturës së përshtatshme për lehtësimin e pjesëmarrjes në votime për personat paraplegjike e tetraplegjike, pajisjen e komisioneve të qendrave të votimit me mjete të posaçme votimi për personat që nuk shikojnë.

Në kuadër të Zgjedhjeve të Përgjithshme 2017, me qëllim krijimin e kushteve të nevojshme që personat me aftësi të kufizuar të ushtrojnë lirisht të drejtën e tyre kushtetuese,

## **REKOMANDOJMË**

*Marrjen e masave për të garantuar të drejtën e votës për personat me aftësi të kufizuar në territorin e Shqipërisë.*

Në përputhje me nenin 22, të ligjit nr.8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, ku thuhet se;

*“Organet të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar një rekomandim, kërkesë apo propozim për shkarkim, duhet t'a shqyrtojnë rekomandimin, kërkesën apo propozimin për shkarkim dhe të kthejnë përgjigje brenda 30 ditësh nga data e dërgimit të rekomandimit, kërkesës apo propozimit për shkarkim. Përgjigja duhet të përmbajë shpjegime të arsyetuara për çështjen në fjalë, si dhe çfarë veprimesh, mosveprimesh apo masash ka ndër marrë ai organ”,*

Lutemi të na vini në dijeni për qëndrimin tuaj, ndaj këtij rekomandimi.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin Tuaj,

**AVOKATI I POPULLIT**

**Igli TOTOZANI**